



**Salman Rushdie**  
Plagët e pashëruara të një shkrimtari

NE FAQEN 14



**Këshillat**  
Keni dhimbje shpine? Ja si mund t'ia dalim

NE FAQET 18-19



**Përvjetori**  
Buzëkuqet, jo vetëm joshje dhe feminitet

NE FAQEN 20



# Shqip



Adresa e redaksisë:  
Rr. Sami Frashëri,  
Pallatet e Aviacionit, Nr. 4  
Tel: 04 2 272 565 • 069 20 35 300  
E-mail: info@gazeta-shqip.com

Drejtor **BESNIK MYFTARI**  
Kryeredaktor **URIM BAJRAMI**

Viti IV - Nr. 177 (1188) E martë, 30 qershor 2009 E përditshme e pavarur Çmimi 50 lekë, 1.5 euro

www.gazeta-shqip.com

ZGJEDHJET 2009/ Përmbysen parashikimet e "exit poll"-eve. Numërohen më shumë se gjysma e kutive. PS "fiton" terren. Rivalitet i fortë në disa qarqe

## Nisin incidentet, frikë për manipulime

*Ndërprerje dritash dhe tension në disa QNV. Rama: Policia të mos bjerë pre e presionit*

A shtu siç pritej, votimet e qeta të së dielës u pasuan nga një fazë e dytë e tensionuar dhe plot probleme. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, sipas Kodit Elektor, duhet të shpallej dje në orën 17:00, por edhe pse provat ishin bërë dhe kjo konsiderohej e mundur, procesi u zvarrit aq sa nuk është e sigurt nëse do të kemi edhe sot një rezultat. Nuk është e tepërt të thuhet se lufta për votën...

NE FAQET 2,3, 11

### Raporti paraprak i të huajve

## Vëzhguesit: Progres, por jeni larg standardeve



NE FAQEN 4

### Paralajmërimi: Proporcionali rrezikon krizë Media e huaj, me "sy e veshë" në Shqipëri

Media e huaj i vlerësoi zgjedhjet e zhvilluara të dielën në Shqipëri si "relativisht të qeta", duke marrë parasysh se së paku në ditën e zgjedhjeve nuk pati dhunë të konsiderueshme apo gjak. Megjithatë, ajo i përmendi ngjarjet e pakëndshme të fushatës si "dhunë dhe gjak". Por shumë gazetarë përmendën gjithashtu faktin se sistemi aktual i përfaqësimit proporcional mund të sjellë mungesë mazhorance qeverisëse dhe krizë të re për vendin...

NE FAQEN 23

### Gjithsesi, PD-ja fiton në zonën e tragjedisë Ndëshkimi, "Gërdeci" asnjë votë për PR-në

NE FAQEN 6

### Berisha ndjek zhvillimet nga zyra qeveritare Festimet, militantët e PD-së ndalin vrapin

NE FAQEN 7

### SHBA-BE: ZGJEDHJE TE QETA, POR ME PROBLEME

Në kohë që në Shqipëri vazhdon procesi i numërimit të votave të së dielës për zgjedhjet e përgjithshme në vend, nga Brukseli vijnë deklaratat dhe vlerësimet e para, të bazuara në raportin paraprak të vëzhguesve...

NE FAQEN 5

### GROSNIK: VLERESIME POZITIVE PER POLICINE

Përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare që monitoruan zgjedhjet në vendin tonë, në raportin e tyre paraprak, i cili përgjithësisht ishte mbushur me jo pak të meta për procesin zgjedhor, iu përgjigjën edhe...

NE FAQEN 21

Bllokohet administrata e shtetit Zyrtarët, me sytë... nga televizori

Në një kohë kur orë pas ore e minutë pas minute, media dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve flasin për përqindjet që kanë fituar partitë politike në garë, më të stresuarit janë punonjësit e administratës. Nga mëngjesi i hershëm dhe deri në përfundimin e orarit zyrtar, të tjerë edhe pas mbarimit të 8-orarshit, kanë kaluar pjesën...

NE FAQEN 22

Akuza të ndërsjella për tërheqje PD dhe PS përplasen për komisionerët

Partia Demokratike dhe Partia Socialiste kanë replikuar dje me njëra-tjetrën, nëpërmjet konferencave për shtyp nga selitë respektive në lidhje me tërheqjen ose jo të komisionerëve. Partia Demokratike, nëpërmjet zëdhënësës së saj, Majlinda Bregu, i bëri thirrje Partisë Socialiste që t'u kërkojë komisionerëve të saj të vazhdojnë procesin e numërimit dhe të mos...

NE FAQEN 6

### Ekonomi

Papajani: Do ndëshkojmë çdo punonjës që merret me fushatë Kreu i Tatimeve: Zgjedhjet nuk e "penguan" planin tonë

NE FAQEN 12

**FINAL 2016**

Sot në treg  
Gazeta "Shqip" + CD  
**350 lekë**  
Në të gjitha pikat e shitjes së gazetës  
Vetëm CD-ja 300 lekë Shqip

### Ekonomi

AKKP: Fondi prej 600 milionë lekësh shpërndahet në shtator Trojet, shtyhet kompensimi financiar për ish-pronarët

Qeveria kishte premtuar se fondin për ish-pronarët do ta shpërndante brenda muajit qershor 2009, madje para zgjedhjeve. Por fushata mbaroi, ndërsa Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, AKKP, deklaroi se shuma prej 600 milionë lekësh e akorduar nga buxheti i shtetit do të shpërndahet në muajin shtator. Ky fond është planifikuar për vitin...

NE FAQEN 12

**FIFA World Cup Finals**

KALENDARI SUPER BOTËTORI FINALET 1966-2006 1-18 KORRIK

FALAS me gazetën Shqip

Super sport

Pushime ONLINE

www.vas.al

Prenotoni pushime ne Turqi (Antalya), Spanje, Egjipt, Greqi, Dubai, Kroaci etj

**ikubINFO**

Ka dy lloje dijesh:  
(a) dimë diçka vetë;  
(b) dimë ku të gjejmë informacion për diçka.

Për ato që nuk dini vetë, vizitoni:  
www.ikubINFO.com



Kritika bashkëkohore, vlerat ideo-artistike të vargut të Marinajt i vë në të njëjtën nivel me të Camajt, Reshpjes, Agollit e shumë lirikëve të tjerë që tashmë kanë krijuar emër në letrat shqipe dhe më gjerë. Një reflektim mbi librin "Lutje në ditën e tetë të javës", botuar nga "Faik Konica"

# Lirizmi poetik i Gjekë Marinajt

MIKEL GOJANI \*

Krijimtaria e derisotme poetike e shkrimtarit të njohur Gjekë Marinaj përfaqësohet me vëllimet poetike "Mos më ik larg", "Infinit" dhe së fundmi me përmbledhjen poetike "Lutje në ditën e tetë të javës", të botuar kohë më parë pranë shtëpisë botuese "Faik Konica" në Prishtinë. Që në fillim të këtij vështrimi duhet konstatuar se shkrimtari shqiptar Gjekë Marinaj, i cili i ka kaluar kufijtë kombëtarë dhe evropianë, në mënyrë besnike ka ndjekur nismën e tij krijuese, duke manifestuar shenja të avancimit të lirikës së tij, apo ndonjëherë edhe shenja të dukshme të përsosmërisë së saj. Kritika bashkëkohore, vlerat ideo-artistike të vargut të Marinajt i vë në të njëjtën nivel me të Camajt, Reshpjes, Agollit e shumë lirikëve të tjerë, që tashmë kanë krijuar emër në letrat shqipe dhe më gjerë. Poetikën e Marinajt e karakterizon një lirizëm i fuqishëm dhe natyrishtëri e thellësisht poetike. Të shkruesh për përmbledhjen e fundit me poezi të Marinajt, që titullohet "Lutje në ditën e tetë të javës", e të mos prezantojmë mendimin e shprehur të kolosit të letrave shqipe, të Ismail Kadaresë, apo edhe të shkrimtarëve të tjerë evropianë, si Frederik Turner, kandidat për çmim "Nobel" në letërsi, apo të shkrimtarit Wole Soyka, fitues i çmimit "Nobel" në letërsi, 1986, është një moment që nuk mund t'i shmangemi, nuk u shmangemi as kësaj radhe. Shkrimtari Ismail Kadare, duke dhënë vlerësimin e tij në librin e Marinajt "Lutje në ditën e tetë të javës", për këtë vlerë vërtet të çmueshme të letërsisë sonë shprehet se Gjekë Marinaj dallohet ndër poetët më të mirë shqiptarë të kohës dhe shton se: "Kjo do të thotë se ai zë vend midis poetëve më të mirë evropianë. Në universin e tij poetik, ka theksuar Kadare, ka një harmoni të mrekullueshme midis shpirtësisë ballkanase, më e vjetra e kontinentit dhe asaj planetare. Siç ndodh shpesh me poetët e vërtetë, kjo harmoni kalon nga jeta te vepra poetike dhe anasjelltas. Kështu për shembull, kur lexojmë poezinë e tij për kalimin e Akeronit, lumit të skëterës, atë që ndan jetën nga vdekja, s'ka si të mos na kujtohet episodi prekës, ku ai, djaloshi i ri, u arratis nga Shqipëria totalitare më 1990-ën, duke kapërcyer me 'not' një lumë që shërbente si kufi", shprehet në vlerësimin e tij, shkrimtari i madh shqiptar Ismail Kadare. Ndërkaq, shkrimtari i madh, Fridrick Turne, duke folur për vlerat e poezisë së Marinajt, shkruan: "Në një botë ku poezia tingëlton si një mplakje, e rraskapitur dhe si një luftëtare u dorëzua në mbrojtje të pikave të fundit të sensibilitetit letrar, Gjekë Marinaj shpërthen në skenë me

tërë shkëlqimin e rinisë, me energjinë erotike dhe maturinë e një poeti të pjekur. Ai na tregon në mënyrë që ta shohim botën përtej realizmit magjik, përtej mendjemadhësisë metafizike, madje dhe përtej surrealizmit ngjyrëplotë të Europës Lindore, që tregon akoma agun shpresëplotë të civilizimit human", është shprehur shkrimtari Turner. Edhe shkrimtari Wole Soyinka, fitues i çmimit "Nobel" në letërsi, për veprën e Marinajt, ndër të tjera shprehet se nëse



Marinaj vazhdon të shkruajë kështu, ka gjasë se një ditë jo të largët e gjithë bota letrare do ta kuptojë domethënien e fjalëve vlerësuese të prof. Kuye-s për Gjekën, thekson ai.

Poezia e Marinajt është autentike, ajo është mishërim i invencionit, ose observimeve, i mundësive të pafundme të sintezave asociative, i gërshetimit të nuancave të ndryshme të shprehurit, elementet diskursive dhe imagjinatën e frytshme e të paanë. Librit të Marinajt,


"Lutje në ditën e tetë të javës", i paraprin një hyrje e studiuës të spikatur të letrave shqipe, Ndue Ukaj. Libri është i ndarë në një strukturë ciklike të veçantë, si: Autoportreti i avancuar, Mesnatë pa datë në kalendar, 24 orë dashuri, Lutjet e së dielës, Duart e nënës, Rrëfimi i Rozafës, Sugjerim me zë të ulët Ailuro-poda në gjyqin e fjalës dhe Labirintet e mendimeve të tangunit.

Te libri i poetit Marinaj është shkrirë një pjesë e biografsë së tij në biografinë e qenies. Qenia, e cila paraqitet në vargun e Marinajt nuk është e përcaktuar. Marinaj ka lënë një hapësirë që t'i mundësojë lexuesit identifikimin e mesazhit dhe të perceptimit të vargut. Ai ia ka lënë në dorë vetë lexuesit ta kuptojë asociacionin. Asociacioni është në nivelin e vet si mjet te ky poet:

Atmosfera ime është një shtresë e hollë jete a vdekje\ Hidrosfera më mbetet tërësia e djersëve dhe gjakut\ Biosfera më nxit neutronet të veprojnë së bashku, më ndihmon litosferën: fytyrën që mbrojt nga turpi\ V parrëfyer para kodeve të erësirës së Kaosit\ Urrej nga afër efektet e çdo prelude për pushim\ Shkatërrimin e njërit si mundësi e qetësisë së tjetrit\

Të më falë Miltoni, por për mua do të ishte më mirë\ Të jem shërbëtor në parajsë se sa sundues në ferr. (Poezia, "Autoprotret", f.19).

Cikli i dytë i përmbledhjes, "Mesnatë pa datë në kalendar", sjell poezi me vlera të larta ideo-artistike, në të cilat metafora, si figurë stilistike përshkohet në



tërë vargjet. Edhe mesazhet që shpalo autorit janë tepër interesante dhe japin për të kuptuar shumëçka për jetën, po ashtu edhe për vdekjen dhe kozmosin në përgjithësi. Poezitë e Marinajt në këtë pjesë të librit përshkohen nga shumë emocione, që poeti i ndjen në qenien e tij duke përcjellë te bota përjetimet e tij, në trajtat e shkrimit.

Edhe në ciklin e katërt, "24 orë dashuri", vërejmë poezi të një ligjërimi të drejtpërdrejtë lirik, prandaj edhe ndjeshmëria kaq e madhe e njëjtimit të temave dhe motiveve që ndërtohen në këtë pjesë të librit, janë vlerë e shprehjes qartësuese, përmes një poetike ku poeti shpreh një transparencë të kristaltë. Një fuqi shprehëse mesazheve të këtyre poezive u japin idetë, imazhet dhe mesazhet që ndërtojnë vargjet e goditura dhe të brumosura. Një poezi me fuqi të posaçme shprehëse vërehet sidomos te poezitë, si "Afërdita", "Qiej të përflakur", "Dusitës në 14-vjetorin e martesës", "Muzg", "Më ëmbël seç puth vesa bjeshkën", "24 orë dashuri, Dusitës" etj. Poezitë e ciklit të pestë, "Lutjet e së dielës", karakterizohen për rrafshin medietues të jashtëzakonshëm, ku perceptimet poetike dhe idetë shkrihen në trajtë universi. Në ciklin "Duart e nënës" janë të konceptuara kryesisht poezi që himnizojnë figurën e nënës, tematikë mjaft e shprehur te shumë poetë tanë. Poezitë si "Duart e Nënës", "Në ditëlindjen e nënës", "Himn për prindërit e mi", "Mall për nënën" etj., i karakterizojnë një ngrohësi e thellë e ndjenjës.

Në poezitë e konceptuara në ciklin vijues "Rrëfimi i Rozafës", autori Marinaj figurën mitike të Rozafës e sheh "mjaft origjinale" (Mujë Buçpapaj). Po ashtu, edhe figurat e tjera që janë të përfshira brenda këtij cikli, si Gonxhe Bojaxhiu (Nënë Tereza), të Skënderbeut etj., autori mëton të rikrijojë një dialog poetik, duke e vënë shpeshherë edhe në brendinë e funksionit mishëruës poetik: O Zot\ Sa vështrë\ Jeta e saj\

I mbylli kllapat\ Përpresepapë\ Midis tyre\ Ajo mbeti\ Si një ekuacion i pazgjidhur deri në fund. (Poezia "Nënë Tereza", f. 100). Edhe poezitë e tjera të këtij cikli, siç janë "Shkodra", "Empati për Klinën", "Me kohën e mbështetur në prehër të Kosovës", "Hijet e Klinës", "Për Prend Buzhalën", "Retë", "Luftës së Deçiqit" etj., janë poezi mjaft të realizuara, të cilat brenda vetes ndërtojnë etikën artistike, po ashtu edhe figuracionin filozofik.

Një frymëzim i thellë poetik, po ashtu vërehet edhe te ciklet vijuese të këtij libri, si "Sugjerim me zë të lartë", "Ailuro-poda në gjyqin e fjalës" dhe "Labirintet e mendimeve të tangunit".

Sikur poezitë e cikleve të mëparshme, po ashtu edhe të këtyre të cikleve të fundit i përshkon e njëjta frymë, po ashtu edhe i njëjti vokacion. Poezitë e Marinajt, të kapërthyer brenda këtyre koncepteve, sendërtojnë synimet krijuese, pikësëpari me qartësinë, komunikimin dhe përjetimin e saj të drejtpërdrejtë me krijimin e një mozaiku tematik e motivor. Një fuqizim shprehës dhe motivor e hasim sidomos te poezitë si "Fluska mbi Adriatik", "Si na vajtonte gjyshja ime ne emigrantët në 1990-ën", "Shqipëri", "I paimunitet në Shqipëri", "Fytyrat në rrethin e dytë të purgatorit", "Fishtës", "Sot u lind Fridrik Reshpja", "Nëna e poetit Luigi Çekaj dha shpirt", "Migjeni" etj. Përkushtimi dhe dhembja janë një simbiozë e ndërlikur shumë fuqishëm, që i japin edhe më shumë jetë poezisë së Marinajt, edhe si vlerë artistike, por edhe si vlerë motivore. Atdhedashuria në poezitë e Marinajt është shprehur në formë filozofike, në universin e së cilës shpalo peshën e etikës që ka krijuari për imazhet, idetë dhe mesazhin që ndërtohen vargu i tij, por edhe me shprehjen që qenësinë e vet ta ruajë kudo. I gjithë libri në tërësi përbën një metaforë të madhe të jetës dhe të pasjetës, ku gjithëherë ngarend për të kuptuar misterin dhe sublimen, tragjikën dhe të zakonshmen etj. Kështu, në përfundim mund të konstatojmë se poeti Gjekë Marinaj me poezinë e tij i sjell një model të rrallë poetik lexuesit shqiptar dhe letërsisë shqipe.

\* Studiuës, Prishtinë

## Festivali

Rreth 16 orkestra frymore nga vendi dhe të huaja do të jenë edhe në Himarë

# Bandat frymore, për të katërtin vit në Sarandë

Për të katërtin vit me radhë, në qytetin e Sarandës do të organizohet festivali i orkestrave frymore, "Albanian Wind Band Festival". Nga data 7 deri më 11 korrik, 16 banda nga vendi dhe bota do të jenë pjesë e jetës artistike në jug të vendit. Përveç Sarandës, bandat frymore do të jenë edhe në Himarë në datat 8-9 korrik. "Festivali i sivjetshëm do të ketë një dimension të ri. Do të marrin pjesë të gjitha bandat e vendit tonë, sikurse edhe ansamble të ndryshme frymore. Ndërkaq do të ketë një pjesëmarrje më të madhe edhe nga rajoni e më gjerë. Kemi marrë konfirmime nga Greqia, Holanda dhe Italia", shprehet Edmond Doko, drejtori i festivalit. Teksa flet për një festival të kthyer në traditë, Doko shprehet se "mjeshtrit frymorë nga i gjithë



vendi dhe festivali janë ndërkohë një realitet i rëndësishëm artistik dhe mbeten një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit artistik të orkestrave frymore që kanë "fatin" të jenë themeli i kulturës muzikore kombëtare. Festivali ynë nuk është vetëm aktivitet kombëtar, por me dimension rajonal e më gjerë. Përplekja e puna jonë e përbashkët është e motivuar nga dëshira për t'u integruar në zhvillimet kulturore e jo vetëm, që koha e nevojta për prosperitetin e vendit imponon". Banda e parë frymore në Shqipëri është krijuar në Shkodër më 1878-ën nga italiani Xhani Canale. Tre vjet më vonë e drejton këtë orkestrë i shquari Palok Kurti e për më shumë se gjysmë shekulli trashëgimtarë të familjes Kurti drejtojnë orkestra frymore në Shkodër.